| 18. | <p>Ctg-Karditograf <i>Karditograf:</i> <i>Monitor fetal per matjen e rrahjeve te zemres se fetusit dhe kontraksioneve uterine.</i> <i>Karakteristikat Teknike:</i> <i>1.Metoda e matjes se FHR:Pulsed Doppler</i> <i>2.Diapazoni i matjes se FHR: i perfshire ne diapazonin 30-240 bpm</i> <i>3.Hyrja me tre kanale per FHR1,FHR2,UC probe</i> <i>4.I paisur me markues eventesh</i> <i>Ekrani:</i> <i>Ne ekran duhet te shfaqen te pakten grafiku I FHR,grafiku I UC,numri I rrahjeve FHR1,numri I rrahjeve FHR2 dhe numri I UC.</i> <i>Paisja te jete e paisur me altoporlant.</i> <i>Alarmet:</i> <i>Te aktivizohet kur kalohet limiti I HR</i> <i>Ne ekran te jepet mesazh kur:</i> <i>a.Printeri nuk ka leter</i> <i>b.Kur kapaku i printerit nuk eshte I mbyllur</i> <i>c.Kur sondat nuk jane te lidhura</i> <i>d.Kur bacteria eshte e shkarikuar</i> <i>I paisur me bateri per perdorim pa energji elektrike</i> <i>Tensioni i hyrjes 220V 50 Hz</i></p> |

| | |
|-----|---|
| | <p><i>I paisur me:</i> <i>Sonda Ultrasonike-2cope,Sonde Toko-1 cope,Shenues eventesh-1cope,gjel,rrip fiksues per sondat,leter printeri</i></p> |
| 19. | <p>Grafi</p> <p><i>1.Tavolina e Pacientit</i></p> <p><i>a.Tavoline e levizshme ne drejtimet longitudinal dhe trasversal me mekanizem kycje e perbere nga material rontgulecent.</i></p> <p><i>b.Gjatesia e Tavolines:Jo me e vogel se 220 cm</i></p> <p><i>c.Gjeresia e Tavolines:Jo me e vogel se 70 cm</i></p> <p><i>d.Pesha mbajtese e tavolines:Jo me e vogel se 180 Kg</i></p> <p><i>e.Diapazoni I levizjes se tavolines ne drejtimin longitudinal(gjatesore):Jo me e vogel se +/- 45 cm</i></p> <p><i>f.Diapazoni i levizjes ne pozicionin trasversal(lateral):Jo me e vogel se +/- 12 cm</i></p> <p><i>g.Lartesia e tavolines afersisht 75cm</i></p> <p><i>2.Stativi Vertikal(Bucky Wall Stand)</i></p> <p><i>a.Stativ vertical i fiksuar ne toke</i></p> <p><i>b.Lartesia minimale e poterit nga toka:Jo me shume se 41 cm</i></p> <p><i>c.Lartesia maksimale e qendres se poterit nga toka:Jo me pak se 1900 cm</i></p> <p><i>d.Komponent frenues</i></p> <p><i>3.Kolona-Krahu Mbajtes i Tubit</i></p> <p><i>a.Tipi i montimit te krahut te tubit:I montuar ne toke</i></p> <p><i>b.Lvizja longitudinale(gjatesore) e krahut mbajtes te tubit:Jo me pak se 180cm</i></p> <p><i>c.Lvizja vertikale e tubit X-Ray,diapazoni i distances:Jo me pak se 190 cm</i></p> <p><i>e.Rrotullimi i tubit te Rrezeve X:Te pakten 90°</i></p> <p><i>4.Kolimatori</i></p> <p><i>a.I perdorshem manualisht</i></p> <p><i>b.Lazer,drite pozicionimi Led</i></p> <p><i>c.Filtra rrezatimi built-in</i></p> <p><i>5.Tubi i Rrezeve X</i></p> <p><i>a.Numri i focal spot ne tubin e Rrezeve X:Jo me pak se 2</i></p> <p><i>b.Diametrat e focal spot:0.6 mm ;1.2mm</i></p> <p><i>c.Voltazhi i Tubit te Rrezeve X:Jo me pak se 150kV</i></p> <p><i>e.Kapaciteti termik i anodes:Jo me pak se 300kHU</i></p> <p><i>6.Gjeneratori</i></p> <p><i>a.Gjenerator me frekuence te larte</i></p> <p><i>b.Linja 3faze 400/480 VAC</i></p> <p><i>c.Kapaciteti i gjeneratorit :Jo me pak se 50 kW</i></p> <p><i>d.Diapazoni i ndryshimit te voltazhit te anodes,jo me pak se 40-150kV</i></p> <p><i>e. rryma maksimale jo me pak se 320mA</i></p> <p><i>f.Software me parametra te pararendosura per ekzaminime anatomike(kV,mAs etj) automatike</i></p> |

| | |
|-----|---|
| | <i>ose manual.</i> |
| 20. | <p>Sistem CR</p> <p><i>Dixhitalizues me permasa tavoline me te pakten nje slot kasetash.</i></p> <p><i>Sistem skanimi per leximin e te pakten 3 formate kasetash afersisht 35x43cm,24x30cm,18x24cm</i></p> <p><i>Sistemi te vije me te pakten tre kasetat e lartpermendura</i></p> <p><i>Te suportoje kapacitete leximi ne densitet: 160 μm lexim I shpejte , 80 μm lexim I ngadalte</i></p> <p><i>Resolucioni i kontrastit grayscale:Te pakten 16 bit / pixel</i></p> <p><i>Kompatibilitet me standartin Dicom 3.0</i></p> <p><i>Kapaciteti:Jo me pak se 70 kaseta ne ore me format 35x43cm</i></p> <p><i>Konsola e Kontrollit</i></p> <p><i>Paisje PC me monitor per kontrollin e CR,me menaxhim dhe perpunim te imazhit</i></p> <p><i>Sistemi operativ Windows 10 ose me i ri</i></p> <p><i>Software per procesimin e imazheve X-Ray</i></p> <p><i>Kompatibilitet i plote i software me standartin dicom 3.0</i></p> <p><i>Procesim automatic dhe manual I imazheve X-Ray</i></p> <p><i>Inversion(negative/positive) te imazheve</i></p> <p><i>Rregullim i parametrave te imazhit(madhesi,contrast,ndricim)</i></p> <p><i>Eksportim i imazheve ne disk dhe USB</i></p> <p><i>Mundesi printimi te disa imazheve te ndryshme ne te njejtin film</i></p> |
| 21. | <p>Printer per filma grafi</p> <p><i>Te kete te pakten dy sirtare(tray) per vendosjen e filmave</i></p> <p><i>Madhesia e filmave qe duhet te suportoje(te pakten keto madhesi filmash):14"x17"(35x43cm);11"x14"(28x35cm); 10"x12"(25x30cm); 8"x10"(20x25cm)</i></p> <p><i>Pixel Size:Te pakten 320dpi</i></p> <p><i>Kompatibilitet i plote me standartin Dicom 3.0</i></p> <p><i>Printeri te shoqerohet me 600 filma</i></p> |
| 22. | <p>Negativoskop</p> <p><i>Te jete i pershtatshem per vendosjen e 2 grafive</i></p> <p><i>Dimensionet afersisht 38x92 cm</i></p> <p><i>Energjia elektrike: 220V 50/60Hz</i></p> |
| 23. | <p>Autorefraktometer</p> <p><i>Refractive mesaurment range:</i></p> <p><i>Vertex Distance:0.0,12.0,13.75,15.0mm</i></p> <p><i>Sphere mesaurment range:Vlera te perfshira ne diapazonin -30D~+25D ,step(0.12,0.25)</i></p> <p><i>Cylinder mesaurment range:0~+/-10D(0.12/0.25 step)</i></p> <p><i>Axis mesaurment range:0~180°(1° step)</i></p> <p><i>Minimum pupil diameter measurable:2 mm</i></p> <p><i>Corneal Curvature Radius Mesaurment</i></p> <p><i>Corneal refractivity mesaurment range:Vlera te perfshira ne diapazonin 33.00D~67.5D(index n=1.3375)(0.12/0.25 step)</i></p> <p><i>Degree of corneal astigmatism mesaurment range:0D~+/-10D(0.12/0.25 step)</i></p> <p><i>Symbol:mm,-D,+D</i></p> <p><i>Axis angle mesaurment range:0~180°(1° step)</i></p> <p><i>Pupil diameter mesaurment range:2mm~8.0mm(0.1mm step)</i></p> |

| | |
|-----|--|
| | <p><i>Fuqia e hyrjes:220-240 Volt,50/60HZ</i></p> <p><i>Paisja te jete e paisur me monitor LCD</i></p> <p><i>Paisja te jete e paisur me printer termik</i></p> |
| 24. | <p>2.Biomikroskop+Tonometer</p> <p><i>Microscope type:Galilean</i></p> <p><i>Eyepiece:minimumi 12.5X</i></p> <p><i>Total magnification:Vlera te perfshira ne diapazonin 40x->6X</i></p> <p><i>Angle between eyepieces:minimum 10°</i></p> <p><i>Eyepieces diopter range:minimum +/-5D</i></p> <p><i>Slit Width:Continuosly variable from 0 to 14mm</i></p> <p><i>Slit image length: e perfshire ne diapazonin 1-14mm</i></p> <p><i>Illumination field diameter: 14mm,10mm,5mm,3mm,2mm,1mm,0.2mm</i></p> <p><i>Slit Angle:0~180°</i></p> <p><i>Slit inclination:0°,5°,10°,15°,20°</i></p> <p><i>Lamp:Halogjene ose Led</i></p> <p><i>Fuqia e hyrjes:220Volt,50Hz</i></p> <p><i>Paisja te kete te inkorporuar dhe nje tonometer aplanacioni</i></p> |
| 25. | <p>Kuti Lente Prove</p> <p><i>Set lentesh me 266 cope, kornize metalike</i></p> |
| 26. | <p>Projektor+Tabele</p> <p><i>Distanca e projektimit:Vlera te perfshira ne diapazonin 2-7m</i></p> <p><i>Zmadhimi i Projeksionit:30x ne distancen 5 m</i></p> <p><i>Grafiket:Minimumi 30 grafike</i></p> <p><i>Permasat e Projeksionit:Minimumi 330mmx220mm(WxH) ne distance 5 m</i></p> <p><i>Burimi i drites:Halogjene ose Led</i></p> <p><i>Projektori te jete i paisur me tabelen projektuese</i></p> <p><i>Fuqia e hyrjes:220-240Volt 50/60Hz</i></p> |
| 27. | <p>Endoskop Nazal</p> <p><i>Endoskop nazal fleksibel.</i></p> <p><i>Sistem me cilesi te larte me pamje high resolution</i></p> <p><i>Unit i perbere nga Rinofaringoskopi fleksibel dhe nga nje unit i shfaqjes se videos dhe imazhit dhe perpunimit te tij.</i></p> <p><i>Mundesasi aspirimi.</i></p> <p><i>Te kete te inkorporuar nje burim drite Led</i></p> <p><i>Te kete diameter te insertion Tube jo me i madh se 3.8mm</i></p> <p><i>Bending(Up/Down)-perthyerja e pjeses fundore(Lart/Poshte):jo me e vogel se 130°/130°</i></p> <p><i>Gjatesia e punes(working length):Jo me e madhe se 330mm</i></p> <p><i>Fusha e pamjes:Jo me e vogel se 90°</i></p> <p><i>Te kete mbrojtje ndaj ujit te pakten IPX7</i></p> <p><i>Furnizuar me pinceta per marrje biopsied he pinceta per heqjen e trupave te huaj</i></p> |
| 28. | <p>Spekulum Nazal</p> <p><i>Material i sterilizueshem celik inoksidant model Kilian/Hartmann</i></p> <p><i>Permasa te ndryshme 14.5cm/31mm; 16cm /31mm</i></p> <p><i>Sasia nga dy cope per secilin model</i></p> |
| 29. | <p>Kanjule Nazale</p> |

| | |
|-----|---|
| | <i>Kanjule aspirimi hunde. Material I sterilizueshem celik inoksidant. Te kete permasa te pjeses fundore ø5mm gjatesia 18cm</i> |
| 30. | Aspirator <i>Te jete i pershtatshem ne procedurat ORL Motori:Pompe me piston Fluksi i Ajrit te mos jete me i vogel se 15l/min. Vakumi i rregullueshem ne vlera te perfshira ne 0-0.75 bar Gote e autoklavueshme 1 litershe Tensioni i hyrjes 220-230Volt</i> |
| 31. | Bajonete <i>Te jete model Lucae me permasa 14 cm, serrated. Material i sterilizueshem celik inoksidant</i> |
| 32. | Spekulum Veshi <i>Material i sterilizueshem celik inoksidant model Hartmann Set me 3 cope me diameter 4-5-6mm</i> |
| 33. | Kanjule Veshi <i>Kanjula aspirim veshi. Material Celik inoksidant. Te kete permasa te pjeses fundore ø3mm –Sasia:cope 4 Material Celik inoksidant. Te kete permasa te pjeses fundore ø2.5mm Sasia:cope 4</i> |
| 34. | Pince Veshi <i>Pinca veshi model Hartmann. Dimensionet e majes se pines:Gjatesia 11mm Gjeresia:0.6mm-2 cope Pinca veshi model Hartmann. Dimensionet e majes se pines:Gjatesia 6mm;Gjeresia:0.3mm-2 cope</i> |
| 35. | Pasqyre Laringeale <i>Te kete diametrin ne diapazonin 20-22 mm Me doreze metalike te drejte 18 cm</i> |
| 36. | Timpanograme <i>Aparat timpanometrie me disa frekuenca. Mundesi printimi te rezultatit I paisur te pakten me sonde tym probe Te jete i perdorshem per femijet Te kete te perfshire protokolle diagnostike dhe screening</i> |
| 37. | Cistoskop Fleksibel <i>Cistoskop Fleksibel portabel Procesori Imazhit Kompatibel me endoskope fleksibel dhe videoendoskope Njesi e integruar me monitor minimum 10 inch me opsione videoregjistrimi dhe foto Ekran me ngjyra TFT/LCD me resolucion Full HD Mundesi thithje(suction) Me aftesi per kalibrimin e ngjyrave Mundesi ngrirje dhe rrotullimi te imazhit Me kujtese te brendshme per imazhet dhe filmimet e procedurave dhe porte USB per transferimin e tyre Me aftesi per ruajtjen dhe rishikimin e imazheve dhe filmimeve</i> |

| | |
|-----|--|
| | <p><i>Te kete dalje HDMI per lidhje me monitor te jashtem</i></p> <p>Cistoskop Fleksibel</p> <p><i>Video-cistoskop fleksibel kompatibel me procesorin e imazhit me siper</i></p> <p><i>Light Source:Led</i></p> <p><i>Diametri i jashtem i cistoskopit te jete maksimumi 5 mm</i></p> <p><i>Working Length:Minimumi 38 cm</i></p> <p><i>Kanali i punes:Me i vogel se 2.2mm</i></p> <p><i>Levizja(lart/poshte)-Bending(Up/Down):Minimumi(130°/210°)</i></p> <p><i>Cistoskopi te jete i sterilizueshem</i></p> <p><i>Furnizuar me pinceta per kapje dhe biopsy, furce pastrami dhe cante mbajtese</i></p> <p><i>Te kete mbrojtje ndaj ujit te pakten IPX7</i></p> <p>Pajisur me mbajtese endoskopi</p> <p><i>Kompakt dhe i pershtatshem per pajisjet e mesiperme</i></p> <p><i>Pajisur me mbajese per aksesoret</i></p> <p><i>I pajisur me 4 rrota antistatike</i></p> |
| 38. | <p>Shtrat ekzaminimi me pozicion litotomik</p> <p><i>Shtrat Vizite Gjinekologjik(pozicion litotomik)</i></p> <p><i>I perbere prej celiku te paoksidueshem ose i kromuar</i></p> <p><i>Shtrat I perbere nga tre seksione:Pjesa Shpindore;Pjesa e Mesit(ndenjese);Pjesa e Kembeve</i></p> <p><i>I pajisur me bacele dhe me suportte gjunjesh me lartesi te rregullueshme.</i></p> <p><i>Pjesa e kembeve e levizshme dhe e fiksueshme</i></p> <p><i>Pjesa shpindore duhet te jete e fiksueshme ne pozicionin lart ne disa kende</i></p> <p><i>Pesha mbajtese jo me pak se 100 kg</i></p> <p><i>Permasat e peraferta te perfshira ne diapazonin:</i></p> <p><i>a.Gjatesia:1.8m->2m</i></p> <p><i>b.Gjeresia:0.5m->0.8m</i></p> <p><i>c.Lartesia:0.7m->0.8m</i></p> <p><i>Te kete pjesen shpindore me sfungjer te trashe ne diapazonin 4-6cm me mbulesa rezistente ndaj ujit.</i></p> |
| 39. | <p>Rektoskop</p> <p><i>Rektoskop/ sigmoidoskop me obturator me permasa 21x300mm</i></p> |
| 40. | <p>EKG</p> <p><i>Karakteristikat teknike:</i></p> <p><i>Ekg me 12 kanale</i></p> <p><i>a.Me ekran LCD minimum 12 inch</i></p> <p><i>b.Me regjistrim manual ose automatic</i></p> <p><i>c.Me printer thermal te integruar me rezulocion te larte, printim ne formatin 12x1</i></p> <p><i>d.Transferim i te dhenave ne USB</i></p> <p><i>e.Autonomi baterie te pakten 4 ore. Bateria te jete e rikarikueshme.</i></p> <p><i>f.E paisur me filtra: filter EMG, filter i linje AC, etj</i></p> <p><i>g.E paisur me kabull Ekg,ventoza dhe elektrodat e ekstremiteteve per kyset dhe kembet.</i></p> <p><i>h. E paisur me Karrelin perkates.</i></p> |

41.

Eko

Të jetë e përshtatshme për ekzaminimet vaskulare

Të ketë përpunim dixhital për përfitim të imazheve me cilësi të lartë

Të ketë ekran me ngjyra, me teknologji LED dhe rezolucion minimal 1920 x 1080 pixel.

Madhësia e ekranit diagonal të jetë jo më pak se 23.5 inch.

Këndi i shikimit vertical dhe horizontal të paktën 175°.

Pajisur me të paktën 5 porta për sonda të ndryshme konvekse, endokavitare dhe lineare.

Pajisja duhet të mundësojë funksionimin në multi-frekuenca ultrasonike.

Të suportojë sondat me frekuenca në diapazonin minimal 1÷17 MHz

Të ketë panel komandimi multi-funksional me tastjerë të ndricuar dhe butona të programueshëm.

Të ketë panelin e komandimit touch screen LCD, jo më të vogël se 13", me rezolucion 1920x1080. Këndi i shikimit jo më pak se 150°. Me inklinim te pakten 10°

Mundësi zmadhimi skanimit deri në min.10-herë.

Thellësia e fushës së skanimit duhet të garantohet deri në 40 cm

Frekuenca e imazhit "frame rate" të jetë mbi 1550 fps

Ekografia të ketë dipazon dinamik te pakten 300 decibel.

Të përfshihen të gjithë modalitetet e skanimit më poshtë:

2-Dimensional (2D)

Të ketë të mundësi selektimi për min. 5 shkalle frekuencash.

Gain jo më pak se 1- 250

Të ketë mundësi selektimi për 15 ose më shumë harta gri të ndryshme

Të ketë mundësi selektimi për të paktën 12 harta ngjyrosje

Të ketë fokus të rregullueshëm jo më pak se 12 nivele

Te kete funksion bashkimi te imazhve adaptiv jo me pak se 15 lloje

Indeksi i akustikes se indeve te jete te pakten 1400-1700 me jo me pak se 30 nivele

Mikroskanimi te jete te kapten 9 nivele

Color Doppler

Gain i rregullueshëm deri në 250

Densitet i linjës e rregullueshme të paktën 4 nivele

Frame rate jo më pak se 250fps.

Rregullimi i linjës bazë me të paktën 30 nivele

PRF jo më pak se 0.5- 8 kHz

Harta e ngjyrave e rregullueshme jo më pak se 10

Filtri i murit i rregullueshëm të paktën 30-750

Power Doppler

Fuqia e rregullueshëm 0-100%

Filtri i murit i rregullueshëm 30-750

Mundësi selektimi deri në 10 ose më shumë harta ngjyrë

Doppler Spektral PW

Te kete te pakten formatet e paraqitjes : H1/2, H1/4, V1/3, V1/2, V2/3, O1/4,

Të ketë mundësi selektimi për min. 5 shkalle frekuencash.

Shkalla e përsëritjes së pulseve: 1 deri në min. 16KHz

Gjatësia minimale e dritares së kampionimit 1 deri në 24mm

| | |
|-----|--|
| | <p><i>Korrigjimi i këndit jo më pak se 0-70°</i></p> <p><i>Të ketë range dinamik me 10 nivele</i></p> <p><i>Të ketë baseline të rregullueshëm me jo më pak se 17 nivele</i></p> <p><i>Motion Mode</i></p> <p><i>Të ketë Gain të rregullueshëm jo më pak se 1- 250</i></p> <p><i>Të ketë mundësi selektimi për të paktën 5 shpejtesi skanimit</i></p> <p><i>Të ketë opsion për paraqitje të imazhit në 3D</i></p> <p><i>Të përfshihen Software të më poshtëm me licenca pa skadencë:</i></p> <p><i>Paketa e plotë e matjeve Abdominale, gjinekologjike, obstetrike, vaskulare, kardiake, urologjike, pediatrike, pjesët e vogla,</i></p> <p><i>Pakete e matjeve doppler automatike, në kohë reale.</i></p> <p><i>Karakteristika të tjera:</i></p> <p><i>Njësi memorie e integruar me kapacitet minimal 1 TB.</i></p> <p><i>Te ruaje te pakten 600s</i></p> <p><i>Database i përfshirë për pacientët dhe imazhet.</i></p> <p><i>Funksion raportimi me mundësi integrimi të imazheve, matjeve dhe grafikeve parametrike</i></p> <p><i>Mundësi eksportimi i të dhënave në format BMP, JPEG,TIF (imazhe) dhe AVI ,WMV, MP4 (video).</i></p> <p><i>Ndërfaqje: USB, HDMI, VGA, Ethernet (import/export të dhënash), Audio.</i></p> <p><i>Furnizimi me energji: 100-240VAC -50/60Hz</i></p> <p><i>Te kete bateri te integruar per te pakten 1.5ore pune</i></p> <p><i>Sonda dhe aksesore të përfshirë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>1 (një) sondë konvekse,jo më e vogël se 1-7 MHz</i> <i>1 (një) sondë lineare,jo më e vogël se 4-14 MHz</i> <i>1(një) sonde kardiake ,jo me e vogel se 1-7 MHz</i> <i>1 Printer per printimin e ekzaminimit te kryer</i> • <i>Printer termik bardh e zi i integruar</i> |
| 42. | <p><i>Kasko me Elektroda per EEG</i></p> <p><i>marka Micromed ,Modeli Brainquick 3200 ose ekuivalente</i></p> |
| 43 | <p><i>Fotosimulator per EEG</i></p> <p><i>marka Micromed ,Modeli Brainquick 3200 ose ekuivalente</i></p> |

III.2.3. Për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të shtojcën nr. 7 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumenteve të tenderit të modifikuara, bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues “*Fedos SHPK & Trimed SHPK*” ka dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë:

Katalogët e produkteve të ofruara prej tij me emrtimet si më poshtë

- *“Dok_TRIMED_Pjesa_1”*
- *“Dok_TRIMED_Pjesa_2”*
- *“Katalog_FEDOS”*
- *“Artikulli_5”*
- *“Artikulli_7”*
- *“Artikulli_16+38”*

- “Artikulli_18”
- “Artikulli_30”
- “Artikulli_41”

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.5. Në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.6. Në nenin 40 pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.7. Neni 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

- a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

- b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të

standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Referuar dokumentacionit të administruar, Komisioni vëren se, për hartimin e specifikimeve teknike për produktet objekt-prokurimi, autoriteti kontraktor është bazuar në shkronjën “a”, të pikës 3, të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, duke vlerësuar si të domosdoshme dhe të rëndësishme kapacitetet funksionale të produkteve dhe performancën e tyre.

III.2.9. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.9, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “Ne katalog nuk specifikohen rrymat elektroterapeutike të meposhtme: Dinamike, impulsive, bipolar.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes ka pretenduar se: “Në katalogun e paraqitur nga BOE, janë markuar llojet e rrymave elektrotreapeutike që përfshin pajisja e ofruar.

Ndër të tjera është dhe rryma diadinamike e cila përfshin edhe rrymen dinamike, pra kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

Përsa i përket rrymës impulsive, është parimi themelor i funksionimit të çdo pajisjeje TENS (Transcutaneous Electrical Nerve Stimulation), e cila funksionon duke lëshuar/shpërndarë impulse elektrike nëpërmjet sipeërfaqes së lekurës, të cilat targetojnë nervat dhe muskulin, duke ndihmuar në menaxhimin e dhimbjes dhe rikuperimin e të semurit. Çdo pajisje TENS funksionon me anë të impulseve, pra kjo arsye skualifikimi nuk qëndron.

Përsa i përket rrymës bipolare, pajisja e ofruar është kërkuar dhe shoqërohet me 4 elektroda. Pra ajo ka një mekanizem veprimi quadripolar, e cila në vetvete përfshin 2 sete bipolare (anode + katode).

Për sa më sipeër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimin e mësipërm të ankimesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut nuk konstatohen të markuara rrymat sipas specifikimeve të kërkua në DST. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimes për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 9 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “Ne katalog nuk specifikohen rrymat elektrotreapeutike te meposhtme: Dinamike, impulsive, bipolar.”, Komisioni gjykon se ky pretendim qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi nuk konstatohet që të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkua në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit dhe konkretisht specifikimet teknike lidhur me rrymat elektrotreapeutike “Dydinamike” “impulsive” dhe “bipolar”.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.9, lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.10. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.11, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “Nuk perbushe karakteristikën e levizjes (rregullimit) elektrik te pjesës së kokës (c) Karakteristikat (b) dhe (c) arrijnë vlera me të larta se ato të kerkuara edhe pse mund të mos merren parasysh.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes ka pretenduar se: “Në specifikimet teknike kërkohet që b. Lartësia (ngritja e shtratit, pjesës shpindore në pozicionin vertical) e rregullueshme elektrisht me vlera të përfshira në diapazonin 65 cm – 95 cm dhe c. Pjesa e kokës e rregullueshme elektrisht lart në një interval 0-70°.

Në katalog specifikohet se lartësia është në intervalin 47-97 cm dhe pjesa e kokës e rregullueshme është në hapësirën +85°-35°, rrjedhimisht është brenda limitit të kërkuar nga AK. Gjithashtu, pajisja e ofruar funksionon me anë të mekanizmit elektrik dhe hidraulik. Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AR nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankmuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut nuk konstatohet mekanizëm elektrik që rregullon lëvizjen e shtratit. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 11 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “Nuk përmbush karakteristiken e levizjes(rregullimit) elektrik te pjeses se kokes (c) Karakteristikat (b) dhe (c) arrijne vlera me te larta se ato te kerkuara edhe pse mund te mos merren parasysht.”, Komisioni gjykon se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “c. Pjesa e kokës e rregullueshme elektrikut lart” i produktit të ofruar është në intervalin +85o ndërkohë që në Shtojcën 5 ky parameter është kërkuar në intervalin 0 – 70°, duke ofruar produkt me parametër më të mirë dhe që e plotëson parametrin e kërkuar, ndërkohë edhe për parametrin teknik “b. Lartësia (ngritja e shtratit,pjeses shpindore ne pozicionin vertikal) e rregullueshme elektrikut” të produktit të ofruar është në intervalin 47 cm – 97 cm, ndërkohë që në Shtojcën 5 ky parametër është kërkuar në intervalin 65 cm – 95 cm, duke ofruar produkt me parametër më të mirë dhe që e plotëson parametrin e kërkuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.11 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron.

III.2.11. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.13, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “Ne katalog eshte ofertuar peshe gire dhe jo pesha me ngjitje.

Ne katalog eshte kerkuar pasha me ngjitje 2kg-3kg ndersa ne katalog eshte ofertuar vetem nje gire 3 kg”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Në specifikimet teknike kërkohet 1 set me dy copë 2 kg dhe 1 set me dy copë 3 kg.

Në katalog këto specifikime janë të markuara dhe plotësohen 100%.

Emërtimi i produktit për sa kohë nuk përfshihet në specifikimet teknike nuk mund të përbejë arsye skualifikimi

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”

Pretendimi të mësipërm të ankmuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: *“Nga verifikimi i katalogut konstatohen se janë Gira dhe jo pesha me ngjitje. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 13 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX” dhe “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: *“Ne katalog është ofertuar peshe gire dhe jo pesha me ngjitje. Ne katalog është kërkuar pasha me ngjitje 2kg - 3kg ndërsa në katalog është ofertuar vetem nje gire 3 kg”* Komisioni gjykon se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se ofertuesi ka ofruar si gira me peshë 2 kg ashtu edhe girë me peshë 3 kg duke përmbushur specifikimet teknike të Shtojcës 5 të dokumentave të tenderit ku është kërkuar, si në vijim: *“1 set me dy cope 2 kg; 1 set me dy cope 3 kg”*.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.13, lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron.

III.2.12. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.14, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: *“Ne katalog është specifikuar trashësia e shkopi 2.5 cm dhe jo 3.5 cm sic është kërkuar”*.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: *“Artikulli i ofruar është me diametër 2.5 cm dhe jo 3.5 cm. Ky artikull është ofruar nga një kompani e specializuar për pajisje fizioterapie e mirënjohur në tregun europian, e cila përmbush të gjitha standartet e kërkuara për këto lloj pajisjesh. Shkopi i ofruar nga kompania jonë, ka diametër më të vogël, por nuk ndikon në funksionalitetin e pajisjes, pra në funksionimin e ushtrimeve terapeutike. Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”*

Pretendimi të mësipërm të ankmuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se shkopi ka trashësi 2.5 cm dhe jo 3.5 cm sipas DST. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 14 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: *“Ne katalog është specifikuar trashësia e shkopi 2.5 cm dhe jo 3.5 cm sic është kërkuar.”*, Komisioni gjykon se ky pretendim qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “Trashësia” i

produktit të ofruar është me përmasën 2.5 cm, ndërkohë që në Shtojcën 5 ky parameter është kërkuar me përmasën 3.5 cm, duke ofruar produkt me parametër më të ulët dhe që e nuk plotëson parametrin e kërkuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.14 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.13. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.16, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Pësja mbajtëse e shtratit jo e specifikuar

- Bacinela nuk është specifikuar nqs është e inkorporuar me shtratin”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Pësja mbajtëse e shtratit është marrë me deklarat nga prodhuesi i cili nënshkruan se pësja mbajtëse është jo më pak se 100 kg, duke ju përshtatur kërkesës së tenderit.

Në katalog specifikohet se Bacinela është e inkorporuar me shtratin (në katalog thuhet SS BASIN)

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisia e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se pësja e shtratit nuk është e përcaktuar në katalog. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 16 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Pësja mbajtëse e shtratit jo e specifikuar

- Bacinela nuk është specifikuar nqs është e inkorporuar me shtratin”, Komisioni gjykon se ky pretendim nuk qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “Pësja mbajtëse e shtratit” i produktit të ofruar nuk është e përcaktuar në katalogun e dorëzuar nga ankimuesi, por njëkohësisht ankimuesi ka dorëzuar një deklaratë të prodhuesit të produktit, i cili ka deklaruar se pësja mbajtëse e krevatit është 130 kg, duke e përmbushur parametrin e kërkuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit, ku nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar që pësja mbajtëse e krevatit duhet të jetë jo më e vogël se 100 kg, duke ofruar produkt me parametër më të mirë dhe që e plotëson parametrin e kërkuar, ndërkohë edhe për parametrin teknik “I pajisur me bacinele dhe me suporte gjunjesh me lartësi të rregullueshme” të produktit të ofruar nga shqyrtimi i katalogut të produktit të ofruar dhe konkretisht nga foto e këtij katalogu konstatohet se shtrati spitalor i ofruar është i pajisur me bacinele dhe me suporte gjunjesh me lartësi të rregullueshme, duke ofruar produkt që e plotëson parametrin e kërkuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.16

lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron.

III.2.14. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.17, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “Ne katalog nuk specifikohet nqs llampa eshte e fiksueshme ne toke-ne tavoline apo ne mure.

Ne katalog nuk ka specifikim per tensionin e hyrjes. Lartesi e llampes nuk specifikohet Diametri i llampes nuk specifikohet.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka pretenduar se: “Në katalog specifikohet se pajisja ofron varietete suporti si:

- e fiksuar në mure,

- me krahë zgjatimi,

- mbajtëse me rrota,

- në shina me kapëse etj

Në katalog kjo pajisje krahun e artikulluar pa bazament e ka të specifikuar 0.9 m.

Pra pajisja më sipër është një pajisje mjekësore që i përshtatet kërkesës dhe funksionit që AK ka keërkuar.”.

Pretendimi të mësipërm të ankmuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se llampa nuk ka rrota transporti, nuk ka diametër të përcaktuar. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 17 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “Ne katalog nuk specifikohet nqs llampa eshte e fiksueshme ne toke-ne tavoline apo ne mure.

Ne katalog nuk ka specifikim per tensionin e hyrjes. Lartesi e llampes nuk specifikohet

Diametri i llampes nuk specifikohet”, Komisioni gjykon se ky pretendim se: “Ne katalog nuk specifikohet nqs llampa eshte e fiksueshme ne toke-ne tavoline apo ne mure” nuk qëndron,

pasi në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë parametër teknik lidhur me mënyrën e fiksimit të llampës së kërkuar, ndërsa nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametrat teknikë të llampës dhe konkretisht “Tensioni i hyrjes”, “Lartësia” dhe “Diametri” të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit nuk janë të pasqyrura në asnjë pjesë të katalogut të dorëzuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.17 lidhur me mënyrën e fiksimit të llampës nuk qëndron, ndërsa arsyeja e skualifikimit lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të “Tensioni i hyrjes”, “Lartësia” dhe “Diametri”

të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron pjesërisht.

III.2.15. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.18, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “Ne katalog specifikohet diapazoni i matjes se FHR 50 - 240 bpm dhe jo 30 - 240 bpm sic eshte kerkuar.

-Ne katalog specifikohet vetem nje sonde ndersa jane kerkuar tre sonda.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka pretenduar se: “Diapazoni i matjes FHR 50-240 bpm me pak shmangie nga vlera që kërkohet në tender, e cila nuk përbën asnjë problem për pajisjen pasi nuk ndikon në funksionin e saj.

Lidhur me numrin e sondave janë po aq edhe sa kërkohen, 3 sonda: Second one transducer Twins Probe

3 in 1 transducer (FHR, TOCO, FM)

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se Diapazoni i matjes se FHR 50-240 bpm dhe jo 30-240bpm siç është kërkuar, kjo gjë pranohet edhe nga vetë OE. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimes për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 18 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “Ne katalog specifikohet diapazoni i matjes se FHR 50 - 240 bpm dhe jo 30 - 240 bpm sic eshte kerkuar.

-Ne katalog specifikohet vetem nje sonde ndersa jane kerkuar tre sonda”, Komisioni gjykon se ky pretendim qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “2. Diapazoni i matjes se FHR” i produktit të ofruar është në intervalin 50 - 240 bpm, ndërkohë që në Shtojcën 5 ky parameter është kërkuar në intervalin 30 - 240 bpm, duke ofruar produkt me parametër më të ulët dhe që nuk e plotëson parametrin e kërkuar, ndërkohë edhe për parametrin teknik “I paisur me: Sonda Ultrasonike -2cope, Sonde Toko-1 cope” konstatohet se nga shqyrtimi i katalogut të produktit të ofruar nuk pasqyrohet që ky produkt të jetë i pajisur me 3 (tre) sonda sikurse është kërkuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.18 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.16. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.19, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Ne katalog është specifikuar per Tubin e Rrezeve X kapaciteti termik i anodes 140kHU dhe jo 300kHU sic është kerkuar.

- Kolona (krahu mbajtes i tubit) sipas katalogut kryen levizje longitudinale (gatesore) 1400mm=140cm dhe jo 180 cm sic është kerkuar.

- Tavolina (shtrati i grafise) është 2100mm sipas katalogut dhe jo 220cm sic është kerkuar.

- Peshë mbajtëse e shtratit të grafise është 136 Kg dhe jo 180 Kg sic është kerkuar.

- Levizja longitudinale e shtratit në një faqe të katalogut deklarohet +/-470 mm dhe në një vend tjetër të katalogut +/-350mm.

- Levizja trasversale e shtratit në një vend në katalog deklarohet +/-120mm dhe në një faqe tjetër të katalogut +/-115mm.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Tavolina e pajisjes që kemi ofruar ka një gjatësi prej 2100 mm me një shmangie prej 10 cm që nuk ndikon në funksionalitetin e saj.

Në katalog në fagen 34 janë marrë pjesë të manualit të përdorimit ku përfshihen specifikimet e të gjitha modeleve të prodhuesit, por në rastin konkret në kemi ofruar modelin DM-6150, i cili e ka lëvizjen longitudinale të shtratit respektivisht + 470 mm dhe levizjen traversiale 120 mm siç kërkohet nga AK.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se asnjë nga pikat e pretenduara nga ana juaj nuk qëndron, ka dukshëm mospërputhje midis kërkesave të DST dhe atyre të markuara nga ana juaj. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 19 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Ne katalog është specifikuar per Tubin e Rrezeve X kapaciteti termik i anodes 140kHU dhe jo 300kHU sic është kerkuar.

- Kolona (krahu mbajtes i tubit) sipas katalogut kryen levizje longitudinale (gatesore) 1400mm=140cm dhe jo 180 cm sic është kerkuar.

- Tavolina (shtrati i grafise) është 2100mm sipas katalogut dhe jo 220cm sic është kerkuar.

- Peshë mbajtëse e shtratit të grafise është 136 Kg dhe jo 180 Kg sic është kerkuar.

- Levizja longitudinale e shtratit në një faqe të katalogut deklarohet +/-470 mm dhe në një vend tjetër të katalogut +/-350mm.

- Levizja trasversale e shtratit në një vend në katalog deklarohet +/-120mm dhe në një faqe tjetër të katalogut +/-115mm.”, Komisioni gjykon se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e parametrave teknikë lidhur me “Kapacitetin termik të anodës”, “Lëvizjen longitudinale (gatesore)”, “Peshën mbajtëse” dhe “Gjatësinë e tavolinës”

qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “Kapaciteti termik i anodës” është 140 kHU, parametri teknik “Lëvizja longitudinale (gatesore)” është 140 cm, parametri teknik “Peshë mbajtëse” është 136 kg dhe parametri teknik “Gjatësia e tavolinës” është 2100 mm, ndërkohë që në Shtojcën 5 këto parametra janë përcaktuar përkatësisht “Kapaciteti termik i anodës” është 300 kHU

parametri teknik “*Lëvizja longitudinale (gjatësore)*” është 180 cm, parametri teknik “*Pesha mbajtëse*” është 180 kg dhe parametri teknik “*Gjatësia e tavolinës*” është 220 cm, duke ofruar produkt me parametëra më të ulët dhe që nuk i plotëson parametrat e kërkuar, ndërkohë lidhur me pretendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave përsa i përket të dhënave të ndryshme që jepen në katalog lidhur me parametrat teknik të “*Lëvizjes longitudinale*” dhe “*Lëvizjen trasversale*” Komisioni gjykon se ky konstatim i autoritetit kontraktor është i vërtetë dhe përsa kohë që ky informacion është kontradiktor gjykon se ky pretendim i autoritetit kontraktor qëndron.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.19 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.17. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.20, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Ne katalog specifikohet rezolucioni i kontrastit 12 bit dhe jo 16 bit sic eshte kerkuar

- Ne katalog specifikohet se mund te perpunohen 60 kaseta ne ore dhe jo 70 kaseta ne ore sic eshte kerkuar.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes ka pretenduar se: “Pajisja e ofruar perpunon reth 60 kaseta në orë të formatit 14" x 17" dhe rreth 68 kaseta të formatit 14" x 14", apo 72 kaseta t e formatit 8" x1 0".

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se rezolucioni i kontrastit është 12 bit dhe jo 16 bit siç është kërkuar, përpunimi i kasetave 35 x 43 është 60 kaseta në ore jo 70 siç është kërkuar. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimes për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 20 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Ne katalog specifikohet rezolucioni i kontrastit 12 bit dhe jo 16 bit sic eshte kerkuar - Ne katalog specifikohet se mund te perpunohen 60 kaseta ne ore dhe jo 70 kaseta ne ore sic eshte kerkuar.”. Komisioni gjykon se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e parametrave teknike lidhur me “*Rezolucionin e kontrastit*” dhe “*Kapaciteti: Jo më pak se 70 kaseta në orë në formatin 35 x 43 cm*” qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “*Rezolucionin e kontrastit*” është 12 bit/pixel dhe parametri teknik “*Kapaciteti: Jo më pak se 70 kaseta në orë në formatin 35 x 43 cm*” është 60 kaseta në orë, ndërkohë që në Shtojcën 5 këto parametra janë përcaktuar përkatësisht “*Rezolucionin e kontrastit*” është jo më pak se 16 bit/pixel dhe parametri teknik “*Kapaciteti: Jo më pak se 70 kaseta në orë në*

formatin 35 x 43 cm” është jo më pak se 70 kasete në orë për kasete të formatit 35 x 43 cm, duke ofruar produkt me parametëra më të ulët dhe që nuk i plotëson parametrat e përcaktuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.20 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.18. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.21, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Nuk permbane formatin e kasetes 28 x 35cm”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Prodhuesi i pajisjes që ne ofertojmë, i cili është 1 prodhues i mirënjohur botëror, ka zgjedhje të madhësive standarte të filmave që përdoren më gjërësisht në botë, pra jo 28 x 35 cm, por 26 x 36 cm. Kjo shmangie e vogël nuk ndikon as në cilësinë e imazhit e as në funksionalitetin e pajisjes.”

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet dhe funksionalitetin e pajisjes 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankmuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se nuk përmban formatin e kasetës 28 x 35 cm siç është kërkuar, kjo gjë pranohet edhe nga vetë OE. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 21 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Nuk permbane formatin e kasetes 28 x 35cm”, Komisioni gjykon se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e parametrave teknikë lidhur me “*Madhesia e filmave qe duhet te suportojete(pakten keto madhesi filmash)*” qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se produkti i ofruar nuk përpunon kasete të madhësisë 28 x 35 cm, ndërkohë që në Shtojcën 5 për këtë parametër teknik janë përcaktuar madhësitë e kasetave që duhet të përpusojë dhe konkretisht madhësitë si në vijim: “*14”x17” (35x43cm); 11”x14” (28x35cm); 10”x12” (25x30cm); 8”x10” (20x25cm)*”, duke ofruar produkt që nuk përpunon kasete të madhësisë 28 x 35 cm, sikurse është përcaktuar në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.21 lidhur me mosplotësimin e specifikimeve teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit të modifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.2.19. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.23, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Ne katalog ka mosperputhje te karakteristikave te meposhtme nga ato te kerkuara:

- Vertex Distance: 13.5mm dhe jo 13.75mm sic eshte kerkuar

- Cylinder mesaurment range: 0.00+/-12.00D dhe jo ne intervalin 0.00+/-10.0D sic eshte kerkuar

- Corneal refractivity ne intervalin 25.96-67.5D dhe jo ne intervalin e kerkuar 33.0D-67.5D

- Corneal astigmatism ne vlera 0.00-15.0D dhe jo ne vlerat 0D +/-10D”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Pajisja e ofruar ka një devijim shumë të vogël të Vertex Distance prej 0.25 mm e cila nuk ndikon në funksionin e pajisjes.

Cylinder mesaurment range: 0.00+/-12.00D e përfshin intervalin 0.00+/-10.0D siç është kërkuar nga AK.

Corneal refractivity në intervalin 25.96 - 67.5D e përfshin intervalin e kërkuar 33.0D -67.5D.

Corneal astigmatism në vlera 0.00 -15.0 D e përfshin intervalin e kërkuar në vlerat 0D+/-10D.

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AR nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet dhe funksionalitetin e pajisjes 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se vetë operatori e ka pranuar se ka një devijim të vertex distancë prej 0.25 mm. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 23 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Ne katalog ka mosperputhje te karakteristikave te meposhtme nga ato te kerkuara:

- Vertex Distance: 13.5mm dhe jo 13.75mm sic eshte kerkuar

- Cylinder mesaurment range: 0.00+/-12.00D dhe jo ne intervalin 0.00+/-10.0D sic eshte kerkuar

- Corneal refractivity ne intervalin 25.96-67.5D dhe jo ne intervalin e kerkuar 33.0D-67.5D

- Corneal astigmatism ne vlera 0.00-15.0D dhe jo ne vlerat 0D +/-10D.”, Komisioni gjykon

se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e parametrave teknikë përsa i përket “Vertex Distance” qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “Vertex Distance” është 13.5 mm, ndërkohë që në Shtojcën 5 ky parametër është përcaktuar përkatësisht 0.0, 12.0, 13.75, 15.0 mm, duke ofruar produkt me parametëra më të ulët dhe që nuk e plotëson parametrin e kërkuar prej 13.75 mm, ndërkohë lidhur me pretendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për mospërmbushjen e parametrave teknike “Cylinder mesaurment range: 0~+/-10D (0.12/0.25 step)”, “Corneal refractivity mesaurment range: Vlera te perfshira ne diapazonin 33.00D ~ 67.5D (index n=1.3375) (0.12/0.25 step)” dhe “Degree of corneal astigmatism mesaurment range: 0D~+/-10D (0.12/0.25 step)” Komisioni gjykon se nuk qëndrojnë, pasi nga shqyrtimi i katalogut të produktit të ofruar parametri

“Cylinder mesaurment range” është 0.00+/-12.00 D, parametri “Corneal refractivity mesaurment range” është 25.96 – 67.5 D dhe parametri “Degree of corneal astigmatism mesaurment range” është 0.00 – 15.0 D, ndërkohë që në Shtojcën 5 këto parametra janë përcaktuar përkatësisht “Cylinder mesaurment range: 0~+/-10D (0.12/0.25 step)”, “Corneal refractivity mesaurment range: Vlera te perfshira ne diapazonin 33.00D ~ 67.5D (index n=1.3375) (0.12/0.25 step)” dhe “Degree of corneal astigmatism mesaurment range: 0D~+/-10D (0.12/0.25 step)”, duke ofruar produkt me parametra më të mirë dhe që i plotëson specifikimet teknike të Shtojcës 5 të dokumenbtave të tenderit lidhur me këto parametra.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.23 lidhur mospërmbushjen e parametrave teknik “Vertex Distance” qëndron, ndërsa arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave po për këtë artikull objekt-prokurimi, lidhur me mospërmbushjen e parametrave teknik “Cylinder mesaurment range: 0~+/-10D (0.12/0.25 step)”, “Corneal refractivity mesaurment range: Vlera te perfshira ne diapazonin 33.00D ~ 67.5D (index n=1.3375) (0.12/0.25 step)” dhe “Degree of corneal astigmatism mesaurment range: 0D~+/-10D (0.12/0.25 step)” nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron pjesërisht.

III.2.20. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.24, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Ne katalog jepet Slit Width: 0-12mm ndersa eshte kerkuar 0-14mm
- Ne katalog jepet Slit length: 0.3-12mm ndersa eshte kerkuar 1-14mm
- Nuk kuptohet nese tonometri mund te montohet ne Slit Lamp-in e kerkuar.”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka pretenduar se: “Pajisja e ofruar ka disa devijime shumë të vogla të cilat nuk ndikojnë në funksionin e pajisjes.

Tonometri është pajisje e cila gjithmonë montohet tek Slit Lampi, pavarësisht nga prodhuesit. Gjithashtu, kjo pjesë e specifikimit është e përmenduar edhe në faqen 43 të katalogut (Katalog FEDOS), rreshti 3.

Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë, dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet dhe funksionalitetin e pajisjes 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se Slit EIDTH ka devijim dhe nuk është në përputhje me kërkesat e DST. Kjo pranohet edhe nga vetë OE. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimes për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 24 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Ne katalog jepet Slit Width: 0-12mm ndersa eshte kerkuar 0-14mm

- Ne katalog jepet Slit length: 0.3-12mm ndersa eshte kerkuar 1-14mm

- Nuk kuptohet nese tonometri mund te montohet ne Slit Lamp-in e kerkuar.”. Komisioni gjykon se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e

parametrave teknikë përsa i përket “*Slit Width*” dhe “*Slit length*” qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “*Slit Width*” është 0-12 mm dhe parametri teknik “*Slit length*” është 0.3 – 12 mm, ndërkohë që në Shtojcën 5 parametri “*Slit Width*” është përcaktuar 0 – 14 mm, ndërsa parametri “*Slit length*” është përcaktuar 1 – 14 mm, duke ofruar produkt me parametëra më të ulët dhe që nuk e plotëson parametrin e “*Slit Width*” dhe “*Slit length*”, ndërkohë lidhur me pretendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “Nuk kuptohet nese tonometri mund te montohet ne Slit Lamp-in e kerkuar”, Komisioni gjykon se nuk qëndron, pasi në specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit nuk është vendosur një parametër i tillë teknik, ku të demonstronhet që tonometri të mund të montohet në Slit Lamp- in.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.24 lidhur mospërmbushjen e parametrave teknik “*Slit Width*” dhe “*Slit length*” qëndron, ndërsa arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave po për këtë artikull objekt-prokurimi, lidhur me konstatimin se: “Nuk kuptohet nese tonometri mund te montohet ne Slit Lamp-in e kerkuar” nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” qëndron pjesërisht.

III.2.21. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr.27, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Në katalogun e furnizuar nga operatori ekonomik ka paqartësi në qoftë se përmbushet karakteristika e mundësisë së aspirimit”.

III.2.21.1. Nga shqyrtimi i ankesës rezulton, objekti i saj lidhet me vendimmarrjen e KVO-se mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “*Fedos SHPK & Trimed SHPK*”, i cili në formularin e ankesës ka paraqitur si pranë autoritetit kontraktor edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka ngritur pretendime lidhur me skualifikimin e ofertës së tij me pretendimin se artikulli objekt-prokurimi me numër rendor nr. 27 nuk plotëson specifikimet teknike. Ndërkohë, KPP nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe nga verifikimi i arsyeve të skualifikimit të dërguara nga ana e autoritetit kontraktor në llogarinë e operatorit ekonomik “Fedos” SHPK në Sistemin Elektronik të Prokurimit në seancën dëgjimore të datës 15.02.2024 konstatoi, se autoriteti kontraktor e ka skualifikuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Fedos SHPK & Trimed SHPK*” edhe për mospërmbushje të specifikimeve teknike për artikullin me numër rendor nr.27.

III.2.21.2. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.2.21.3. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.2.21.4. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.21.5. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në

autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.21.6. Në nenin 94, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.21.7. Në rastin konkret referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, si dhe raportit të auditit në sistemin e prokurimit publik rezulton, se autoriteti kontraktor ka skualifikuar ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Fedos SHPK & Trimed SHPK” për mospërmbushje të specifikimeve teknike për artikullin me numër rendor nr.27, ndërsa në përmbajtjen e formularit të ankesës të dorëzuar si pranë autoritetit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me vendimmarrjen e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “Fedos SHPK & Trimed SHPK”, ky i fundit nuk ka paraqitur pretendimet për njërën nga arsyet e skualifikimit

dhe konkretisht për arsyen e skualifikimit si në vijim: “Në katalogun e furnizuar nga operatori ekonomik ka paqartësi në qoftë se përmbushet karakteristika e mundësisë së aspirimit”, duke mos shfaqur asnjë pretendim në formularin e ankesës në lidhje me këtë arsye skualifikimi.

Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”. Në rastin konkret KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues nuk i ka ezauruar të gjitha shkallët e ankimit në lidhje me pretendimet e tij mbi arsyet e skualifikimit nga autoriteti kontraktor, pasi për njërin prej arsyeve të skualifikimit (e cila rezulton e provuar pasi nga parashtrimet në ankesë të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues këta të fundit nuk kanë ngritur pretendime për arsyen e skualifikimit) se: “Në katalogun e furnizuar nga operatori ekonomik ka paqartësi në qoftë se përmbushet karakteristika e mundësisë së aspirimit”, në lidhje me këtë arsye skualifikimi bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk ka shfaqur pretendime në formularin e ankesës, duke sjellë në këtë mënyrë edhe rënien në dekadencë të së drejtës së tij dhe humbjen e afatit të ankimit në lidhje me këtë pretendim në kuptim të nenit 110, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Në këtë kuadër KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk ka ezauruar shkallët e ankimit për këtë arsye skualifikimi si më sipër ctuar në lidhje me mospërmbushjen e specifikimeve teknike për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 27.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues është njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor, i cili ka vendosur për skualifikimin e ofertës së këtij të fundit. Brenda afateve të parashikuara të ankimit në nenin 110 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ankimuesi ka parashtruar pretendime në ankesë vetëm për dy nga nga arsyet e skualifikimit në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi në nenin 110 e

vijues të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” ka parashikuar afate strikte mbi paraqitjen e ankesës, afate të cilat për nga natyra juridike janë prekluzive. Kështu, pas përfundimit të afatit të ankimit të vendosur në ligj, në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka pasur pengesë në ushtrimin e të drejtës së ligjshme të ankimit, vendimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij është përfundimtar dhe nuk mund të rishikohet nga një organ tjetër administrativ.

Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimitimi locus standi), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar me një vendim përfundimtar nga autoriteti kontraktor për të cilën ky i fundit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se LPP parashikon në mënyrë eksplicite, se për çdo vendimmarrje të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë që rrezikojnë të dëmtohen nga ky vendim duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të ankimit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda afateve të parashikuara në LPP, duke respektuar të gjitha elementet formale sipas dispozitave ligjore. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Fedos SHPK & Trimed SHPK”, nuk ka paraqitur pretendime për një nga arsyet e skualifikimit dhe me konkretisht në lidhje me arsyen e skualifikimit: “Ne katalogun e furnizuar nga oe ka paqartesi nqs permbushet karakteristika e mundesise se aspirimit”. Referuar përcaktimeve ligjore si më sipër cituar, kërkohet që ankimuesi, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të

ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Për sa kohë që operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për mosplotësim e specifikimeve teknike për artikullin me numër rendor nr. 27, ku për këtë arsye skualifikimi rezulton, se në ankesën e paraqitur nuk ka ngritur pretendime pra nuk e ka kundërshtuar këtë fakt, atëherë për faj të vetë operatorit ekonomik e ka humbur kështu të drejtën për t’u ankimuar brenda afateve ligjore, dhe për rrjedhojë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën.

III.2.22. Lidhur me produktin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 37, Komisioni konstaton se arsyeja e skualifikimit është pretendimi i komisionit të vlerësimit të ofertave se produkti i ofruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues nuk përmbush specifikimet teknike si në vijim: “- Insertion Tube ne katalog eshte 5.2 mm ndersa eshte kerkuar te jete maksimumi 5mm

- Nuk specifikohet nqs Cistoskopi eshte i sterilizueshem

- Nuk specifikohet madhesia e ekranit

- Nuk specifikohet memoria e brendshme”.

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka pretenduar se: “Shmangiet e pajisjes tonë, janë të vogla dhe nuk ndikojnë në funksionalitetin dhe

cilësinë e saj. Gjithashtu pajisjet e ofruara janë të certifikuara sipas standartit të pajisjeve mjekësore të ripërdorshme, prat ë sterilizueshme. Për sa më sipër, arsyet e skualifikimit nga AK nuk qëndrojnë dhe pajisja e ofruar i plotëson specifikimet 100%.”.

Pretendimi të mësipërm të ankimuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës nuk e ka pranuar duke argumentuar se: “Nga verifikimi i katalogut konstatohet se Insertion tube është sjellë më i madh se vlera e kërkuar. Nuk verifikohet nëse cistoskopi është i sterilizueshëm, si dhe nuk specifikohet madhësia e ekranit dhe memorja e brëndshme. Në lidhje me këtë pikë, pretendimi i OE, nuk qëndron.”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, Komisioni konstatoi se operatori ekonomik ankimues për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr. 37 ka dorëzuar katalogun e produktit me emërtimin “XXXX”.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave, si në vijim: “- Insertion Tube ne katalog eshte 5.2 mm ndersa eshte kerkuar te jete maksimumi 5mm

- Nuk specifikohet nqs Cistoskopi eshte i sterilizueshem

- Nuk specifikohet madhesia e ekranit

- Nuk specifikohet memoria e brendshme.”. Komisioni gjykon se ky pretendim i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me mosplotësimin e parametrave teknikë përta i përket “Diametri i jashtëm i cistoskopit te jete maksimumi 5 mm”, “Cistoskopi te jete i sterilizueshem”, “Njesi e integruar me monitor minimum 10 inch me opsione videoregjistrimi dhe foto” dhe “Me aftesi per ruajtjen dhe rishikimin e imazheve dhe filmimeve” qëndron, pasi nga shqyrtimi i katalogut të dorëzuar për këtë artikull objekt-prokurimi konstatohet se parametri teknik “Diametri i jashtëm i cistoskopit” është 5.2 mm, ndërkohë që në Shtojcën 5 parametri “Diametri i jashtëm i cistoskopit” është përcaktuar maksimumi 5 mm, duke ofruar produkt me parametëra më të ulët dhe që nuk e plotëson parametrin e “Diametri i jashtëm i cistoskopit te jete maksimumi 5 mm”, ndërkohë lidhur me pretendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se: “Nuk specifikohet nqs Cistoskopi eshte i sterilizueshem; Nuk specifikohet madhesia e ekranit dhe Nuk specifikohet memoria e brendshme” Komisioni gjykon se qëndron, pasi në katalogun e dorëzuar nga ankimuesi këto specifikime teknike të sipërpërmendura dhe të përcaktuara në Shtojcën 5 të dokumentave të tenderit nuk gjejnë pasqyrim në katalogun e dorëzuar.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për artikullin objekt-prokurimi me numër rendor nr.37 lidhur mospërmbushjen e parametrave teknik “Diametri i jashtëm i cistoskopit te jete maksimumi 5 mm”, “Cistoskopi te jete i sterilizueshem”, “Njesi e integruar me monitor minimum 10 inch me opsione videoregjistrimi dhe foto” dhe “Me aftesi per ruajtjen dhe rishikimin e imazheve dhe filmimeve” qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fedos SHPK & Trimed SHPK” nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Fedos SHPK & Trimed SHPK”, për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me pretendimin se: “2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, ose FDA të vlefshme për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre ne VENDIM Nr. 731, datë 2.9.2015 Për

Miratimin e Rregullit Teknik “Për Kërkesat Thelbësore, Vlerësimin e Konformitetit, Klasifikimin Dhe Markimin Ce të Pajisjeve Mjekësore”, pika 8.4.

Artikulli 20 dhe 21 e kanë të vetdeklaruar CE/nuk vlen

Artikulli 22 vetdeklarim 93/43eec jo deklarate nga nje pale e trete Artikulli 7 vetdeklarim 93/42eec jo certifikim nga pale e trete

Artikulli 21 dhe 21 kanë vetdeklarim të prodhuesit Fujifilm se përmbushë 93/42eec jo certificate nga pale e trete

Artikulli 5, 16, 38 vetdeklarim jo certifikim nga nje pale e trete

Per artikullin 18 vetdeklarim nga prodhuesi.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që oferta e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes “Fedos SHPK & Trimed SHPK” edhe pas shqyrtimit të pretendimeve të tij do të vazhdojë të jetë i skualifikuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, shqyrtimi për pretendimet e tjera të palës ankimese, nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Fedos SHPK & Trimed SHPK” në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Lot 1, me Nr. REF-86448-11-06-2023, me objekt: “F.V pajisje mjekësore për poliklinikën e Sp.Shkodër” me fond limit: 24,694,056.54 (njëzetë e katërmilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katërmijë e pesëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar në datën 20.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik “Fedos SHPK & Trimed SHPK” dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Fedos SHPK & Trimed SHPK”.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri